**VENDIM**
**Nr. 688 , datë 14.11.2018**

# PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË OBJEKTIT ME EMËRTIM "OBORR I QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE 'NËNË TEREZA', TIRANË"

*(ndryshuar me VKM nr. 135, datë 2.3.2022)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c" , të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të një pjese të oborrit të brendshëm të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, me sipërfaqe 10 457 $m^2$,
zona kadastrale nr. 8130, në njësinë administrative nr. 3, Bashkia Tiranë, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim shfrytëzimin
për parkim, përmirësimin e infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse, si dhe menaxhimin cilësor të shërbimeve publike, që do të zhvillohen në këtë sipërfaqe.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim te të tretët që nuk janë në varësi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Nga aktiviteti që do të zhvillojë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për përmirësimin e infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse, si dhe menaxhimi cilësor i shërbimeve publike, që do të zhvillohen në këtë sipërfaqe, do të përfitojë 55% të të ardhurave, ndërsa Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, do të përfitojë 45% të të ardhurave.

4. Vlera prej 45% e të ardhurave, si pjesë takuese e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, do të ndahet sipas modalitetit të mëposhtëm:

*a) 25 (njëzet e pesë) % kalojnë në llogarinë e qendrës spitalore universitare 'Nënë Tereza', Tiranë, prej të cilave:*

*i. 3 (tre) % përdoren për edukimin në vazhdim të burimeve njerëzore të kësaj qendre;*

*ii. 22 (njëzet e dy) % përdoren për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera.".*

*ii. Në shkronjën "b", shifra "42%" zëvendësohet me "20%";*

b) *20%* do të investohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me kërkesë të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, dhe pas miratimit paraprak të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në infrastrukturë, për përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, në përmbushje të objektivave dhe të misionit të saj.

*4/1. Të ardhurat e krijuara që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit dhe të papërdorura kalojnë 80% si të ardhura dytësore në buxhetin e QSUT-së për t'u përdorur për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera dhe 20% do të përdoren nga FSHZH-ja me kërkesë të QSUT-së dhe pas miratimit paraprak të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në infrastrukturë, për përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, në përmbushje të objektivave dhe të misionit.*

*5. Marrëdhëniet ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit do të rregullohen me marrëveshje të përbashkët.*

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Senida Mesi**

*Planvendosja e pasurive që kalojnë nga MSHMS te Fondi Shqiptar i Zhvillimit për llogari të QSUT ,Tiranë.*

*Sipërfaqja totale për hapësirat e parkimit në QSUT: 10457m 2*